



Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2025 të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.NIKA PRO-ING SH.P.K me Numër Unik Identifikues 811052307 me adresë: Rruga “Rexhep Bislimi” p.n Ferizaj, me pronar Shpend Musa, shfrytëzues i pronës të paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.

2.Prona e paluajtshme e komunës gjendet në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve, e përshkruar në evidencen kadastrale përkatëse, si në tabelën në vijim:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim m ² |
|-----|---------------|---------------------|----------------------|---|
| 1. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-11 | Babush i Muhaxherëve | 10000 |

M

3. Shfrytëzimi afatgjatë i pronës komunale prej 99 vitesh do të jetë pa kompensim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës të palujatshme të komunës, siç përcaktohet në nenin 1 pika 2 e këtij vendimi, destinohet kryesisht për: **Fabrikë për riciklimin e qelqit**, ku vlera investive është në shumën prej 4,766,700.00 €, ndërsa numri i të punësuarve nga ky investim do të jetë 78 punëtor nga Komuna e Lipjanit, sipas konceptit të përgjithshëm të projektit NIKA PRO-ING Sh.P.K, Ferizaj datë 10.10.2024.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së palujatshme në ZK- Babush i Muhaxherëve.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektionit, Drejtorati i Infrastrukturës dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

A r s y e t i m

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujatshme të Komunës Nr.06/L-092, të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujatshme të Komunës dhe Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 datë 08.05.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujatshme të Komunës në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve.

Bazuar në aplikacionin dhe dokumentet e tjera përcjellëse si në shkresat e lëndës të datës 14.10.2024 Nr.01-462/01-51733 të ofertuesit, NIKA PRO-ING SH.P.K me Numër Unik Identifikues 811052307 me adresë: Rruga "Rexhep Bislimi" p.n Ferizaj, me pronar Shpend Musa, Komisioni Vlerësues gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ofertuesi i lartëcekur, i ka plotësuar kushtet për marrjen e parcelës komunale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe 10000 m² në ZK-Babush i Muhaxherëve, në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujatshme të Komunës konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092.

Komisioni Vlerësues në procesverbalin e mbajtur në takimin e 5-të me datë 11.11.2024, ka shqyrtuar ofertën NIKA PRO-ING SH.P.K për parcelën 00559-11 me sipërfaqe prej 10000 m², lidhur me realizimin e projektit për: Fabrikë për riciklimin e qelqit, ku vlera investive është në shumën prej 4,766,700.00 €, ndërsa numri i të punësuarve nga ky investim do të jetë 78 punëtor nga Komuna e Lipjanit, sipas konceptit të përgjithshëm të projektit NIKA PRO-ING Sh.P.K, Ferizaj datë 10.10.2024 dhe me datë 10.12.2024 Nr.01-463/02-60878 Komisioni Vlerësues në aktin Njoftim për përzgjedhjen e ofertave sipas Njoftimit Publik Nr.01-462/01-48222 të datës 30.09.2024, ka përzgjedhur ofertuesin NIKA PRO-ING SH.P.K, shfytëzues të parcelës komunale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe prej 10000 m² në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, me shkresë përcjellëse datë 08.01.2025 ref.01-463/02-64055, drejtuar Zyrës së Kryetarit, ka shqyrtuar dy ankesa të parashruara nga ofertuesit si në shkresat e lëndës, të njëjtat janë refuzuar në tërësi të pabazura sipas Vendimit 01-034/01-61836 datë 26.12.2024 dhe Vendimit 01-463/02-64075 datë 08.01.2025 nga Komisioni i Ankesave dhe mbetet në fuqi-Njoftimi 01-463/02-60878 i datës 10.12.2024 për përzgjedhjen e ofertave të Njoftimit Publik Nr.01-462/01-48222 të datës 30.09.2024.

Duke u bazuar në aktin Raport i Komisionit Vlerësues datë 10.01.2025 Nr.15-462/01-2039 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-ZK Babush i Muhaxherëve për vlerësimin e ofertave sipas Njoftimit publik Nr.01-462/01-48222 të datës 30.09.2024, Komisioni Vlerësues ka zbatuar të gjitha procedurat për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092.

Prandaj, duke u bazuar në dhënat e lartëcekura dhe konform dispozitave ligjore në fuqi, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

01-462/01-2657

Lipjan, më 14.01.2025

KRYETARI I KOMUNËS





Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënicen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 dhe nenit 13 të Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 08.05.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

1. Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjenden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të përshkruara si në vijim:

1.1. Njësia kadastrale P-71409059-00559-9 me sipërfaqe 40000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.2. Njësia kadastrale P-71409059-00559-10 me sipërfaqe 20000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.3. Njësia kadastrale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe 10000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.4. Njësia kadastrale P-71409059-00559-12 me sipërfaqe 13137 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.5. Njësia kadastrale P-71409059-00559-15 me sipërfaqe 11172 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi, bëhet në mënyrë që subjekteve të interesuara të i'u mundësohet të ofertojnë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit, sipas standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Pronat e paluajtshme komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës sipas nenit 1 të këtij Vendimi të regjistroj në librat kadastral si pronë të dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-h63/06-22761

Lipjan, më 08.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Dani Azemi



REPUBLIKA E KOSOVËS
 QEVERIA - VLAËA - GOVERNMENT
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministry of Local Government Administration

020-327/6
 21.06.2024

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

| | |
|----------------------|--|
| Për: | Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së |
| Nga: | Erblin Hetem, Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL |
| Zyrtaret përgjegjës: | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave |
| Lënda: | Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Lipjanit |

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim paraprak 15 Nr 463/06-22761 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Babushë i Muhaxhereve
 I miratuar më datë: 08.05.2024
 I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.05.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2024, ka miratuar Vendimin paraprak 15 Nr.463/06-22761 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Babushi i Muhaxhereve i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit është bazuar me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 8 dhe nenin 14 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi paraprak 15 Nr.463/06-22761 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Babushi i Muhaxhereve është miratuar në mbledhjen e Kuvendit me datë 08.05.2024, me 24 vota për 0 kundër dhe 2 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 08.05.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve 15Nr. h63/06-22761 i datës 08.05.24 (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori joqeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Latif Ramadani, nga ekzekutivi i Komunës,
2. Rexhep Rexhepi, nga ekzekutivi i Komunës,
3. Armend Grajqevci, nga subjekti politik LDK,
4. Lulzim Rrustemi, nga subjekti politik PDK,
5. Arbnora Dedushi, nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve _____ të datës _____.

Neni 4
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6
Kompensimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompensohen në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse. Kompensimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompensimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.


Nr. 15-463/06-22763

Lipjan, më 08.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit





| | |
|-------------------------|----------------------|
| Planuar me Primitjen | 30.09.24 |
| Mjesia Jedine | Shtetia Shqiptare |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

01-462/01-48222

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, neneve 14 dhe 20 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr-15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr.15-463/06-22763, të datës 08.05.2024 në ZK Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME
TË KOMUNËS - ZK BABUSH I MUHAXHERËVE**

Komuna e Lipjanit në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr-15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 dhe Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr.15-463/06-22763, të datës 08.05.2024, jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronat e paluajtshme me shënimet në tabelën si vijon:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim m ² |
|-----|---------------|---------------------|----------------------|---|
| 1. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-10 | Babush i Muhaxherëve | 20000 |
| 2. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-11 | Babush i Muhaxherëve | 10000 |
| 3. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-12 | Babush i Muhaxherëve | 13137 |

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura më lartë është krijimi i hapësirës për investitorët serioz për investim në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

L.P.R.R. A.G. J.B. A.D

Pronat komunale në këtë zonë, ofrohen për shfrytëzim sipas Hartës Zonale të Komunës për zhvillim të industrisë (industri e rëndë, e mesme dhe e lehtë), si dhe për shfrytëzime komerciale të cilat janë në shërbim të industrisë.

Shfrytëzimet e lejuara:

- Industri e lëndës së parë,
- Industri e prodhimeve të rënda.
- Industri e prodhimeve të lehta.
- Shërbim tregtar.
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 100 € (njëqind euro), për çdo parcelë kadastrale të ofertuar ndërsa për secilën parcelë nevojitet pliko ose zarfë e veçantë, dhe jashtë kuvertës në njëren anë duhet të shënohet Zona Kadastrale Babush i Muhaxherëve.

Aplikacioni i kompletuar bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur dorzohen në ndërtesën e Komunës kati perdhesë, Qendra për shërbime për qytetarë sporteli 1 dhe 2, në afat prej 15 ditësh kalendarike pas ditës së publikimit të këtij Njoftimi, konkretisht njoftimi është i hapur deri më datën 15.10.2024 në ora 15:00

Hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 16.10.2024 duke filluar në ora 10:00 .

Kriteret për zgjedhjen e ofertave

Zgjedhja e ofertës më të favorshme për Komunën, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:

1. Vlera e investimit;
2. Numri i të punësuarve nga investimi;
3. Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për komunën;
4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;
5. Të plotësojë kushtet dhe kriteret e percaktuara mjedisore;
6. Të jetë në harmoni me Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit.

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

L.P.R.R. A.G. L.B. A.D

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vulloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar.

Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme ZK Babush i
Muhaxherëve**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.1 dhe 2 në formën fizike, dhe në formë elektronike nga Webfaqja e Komunës .

Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr.1 dhe 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi, konkretisht njoftimi është i hapur deri me datën 15.10.2024 në orën 15:00.

Ofertat të pakompletuara të paprecizuara, të panënshkruara nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.


Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Uebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i tretë, Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

Komisioni

1.Latif Ramadani
2.Rexhep Rexhepi
3.Armend Grajqevci
4.Lulzim Rustemi
5.Arbnora Dedushi

Me datë: 30.09.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS

Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme ZK-Babush i Muhaxherëve

APLIKACION PËR KONKURS PUBLIK

Në bazë të Njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr-15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 aplikoj për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës me këto shënime:

| | |
|------------------------------------|----------------|
| Zona kadastrale | |
| Vendi | |
| Ngastra kadastrale | |
| Sipërfaqja | |
| Aplikoj për pronën me numër rendor | (shëno numrin) |

APLIKUESI – PERSON FIZIK

| | |
|--------------------------------------|--|
| Emri , Mbiemri dhe numri i telefonit | |
| Vendbanimi | |
| Adresa | |
| Emri dhe mbiemri të autorizuarit | |
| Numri dhe data e autorizimit | |

APLIKUESI – PERSON JURIDIK

| | |
|--|--|
| Emërtimi i biznesit dhe numri kontaktues | |
| Selia | |
| Adresa | |
| Numri i biznesit | |
| Përfaqësuesi | |
| I autorizuari | |
| Numri dhe data e autorizimit | |

Aplikacionit i bashkëngjeshë kovertën e mbyllur me dokumentet si në vijim:

1.Ofertën;

2.Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;

3.Vërtetimi nga Gjykata që dëshmon që pronari dhe biznesi nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo më i vjetër se 30 ditë)

4.Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues minimalisht për vitin fiskal 2022 nga Administrata Tatimore e Kosovës;

L.E.R.R. A.G L.B. A.D

5.Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj;

6.Projekti tekniko-investiv, në kuadër të këtij plani duhet të përfshihet pjesa tekstuale dhe grafike e projektit ku përfshihen:

- 6.1. Veprimtaria e planifikuar
- 6.2. Sipërfaqja ndërtimore e projektit;
- 6.3. Vlera dhe paramasa investive (nëse vlera investive ndahet në faza, atëherë të prezantohet sipas fazave zhvillimore);
- 6.4. Periudha e realizimit të projektit;
- 6.5. Numri i punonjësve të angazhuar;
- 6.6. Aplikimi i standardeve mjedisore, përkatësisht ndikimi i veprimtarisë së planifikuar në mjedis;
- 6.7. Pjesa grafike e projektit;

7.Fotokopjen e çertifikatës mbi regjistrimin e biznesit;

8.Dëshmi e xhirrollogarisë aktive dhe qarkullimin bankar për vitet: 2021, 2022, 2023.

9.Pagesën e taksës për aplikim.

Lipjan, më datë _____ 2024

APLIKUESI

| | |
|------------------|--|
| Emri dhe Mbiemri | |
| Nënshkrimi | |

L.P.R.R. A.G L.Br A.D

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

5.2.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

| Indeksi i bazës | Industri e lëndës së parë / rëndë | Industri e prodhimëve të larta | Shërbim tregtar | Shërbim tjetër tregtar | Shërbim profesional |
|---|--|--|---|---|---|
| Madhësia e parcelës | Min 2,000m ² | Min 1,500m ² | Min 1,000m ² | Min 1,000 m ² | Min 500m ² |
| Balli i parcelës ¹ | Min 50m | Min 40m' | Min 25m' | Min 25 m' | Min 20m |
| Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN) | Vlera bazë 0.50 Max 1.0 | Vlera bazë 0.50 Max 1.0 | Vlera bazë 0.50 Max 1 | Vlera bazë 0.5 Max 1 | Vlera bazë 0.5 Max 1 |
| Etazhiteti | P + 0 (7.0 m') P + 1 (12 m') | P + 0 (7.0 m') P + 1 (12 m') | B+P+1 Max 9 m' | B+P+0 (5.0 m') B+P+1 (8.0 m') | B+P+1 Max 9 m' |
| Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh) | Max 50% | Max 50% | Max 50% | Max 50% | Max 50% |
| Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP) | 30% | 30% | 30% | 30% | 30% |
| Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP) | 0% | 0% | 50% | 50% | 50% |
| Kushtet e vijave | | | | | |
| Vija Ndërtimore (VN) | Min 10m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët | Min 10m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët | Min 5m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët | Min 5m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët | Min 5m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët |
| Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNt) | Min 10m | Min 10m' | Min 5m' | Min 7m' | Min 5m' |
| Distanca anësore nga parcela – me hapje primare ² | Min 0.25H e ndërtesës | Min 0.25H e ndërtesës | Min 0.25H e ndërtesës | Min 0.25H e ndërtesës | Min 0.25H e ndërtesës |
| Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare | Min 0.10H e ndërtesës | Min 0.10H e ndërtesës | Min 0.10H e ndërtesës | Min 0.10H e ndërtesës | Min 0.10H e ndërtesës |
| Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje | Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët e parcelave fqinje arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri. | | | | |
| <p>1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m², gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m', p.sh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 2,000m² – 2,100m² = 50.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë); • Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 2,101m² – 2,200m² = 12.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës). <p><u>Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë zonë.</u></p> <p>2 - Objektet industriale duhet të vendosen në lokacionet që do të jenë larg zhvillimeve fqinje, si dhe në distanca të përcaktuara me ligjet dhe aktet ligjore përkatëse nga monumentet natyrore e kulturore, dhe resurset natyrore, ashtu që të pengohet apo shmangët ndikimi negativ. Gjithashtu, distanca e këtyre objekteve nga infrastruktura e transportit hekurudhor, infrastruktura ekzistuese e telekomunikacionit, trajtimin e mbeturinave apo të</p> | | | | | |



Data:30.07.2024

Zyrtarisht

Në bazë të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe rregullave të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.30033 të datës 03.06.2021, si dhe kërkesës të parashtruar nga Drejtorati Arsim, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lëshon këtë:

EKSTRAKT NGA HARTA ZONALE E KOMUNËS

| Ky Informacion/ekstrakt lëshohet për: | | | |
|---|----------------------|---|--|
| Emri dhe mbiemri/Aplikuesi: | | • Komisionit për vlerësim të pronave – Latif Ramadani – Drejtor për Buxhet dhe Financa | |
| Adresa: | | Rr."Shqipëria", Lipjan | |
| Për Lokacionin në vijim: | | | |
| Adresa: | | Fshati Babush i Muhaxherëve - Lipjan | |
| Zona kadastrale: | Babush i Muhaxherëve | Parcelat kadastrale: | P-71409059-00559-9, P-71409059-00559-10, P-71409059-00559-11, P-71409059-00559-12, P-71409059-00559-15 |
| <p>Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka shqyrtuar kërkesën lidhur me informacionin urban/ekstrakt nga Harta Zonale e Komunës për parcelat kadastrale: P-71409059-00559-9, P-71409059-00559-10, P-71409059-00559-11, P-71409059-00559-12, P-71409059-00559-15.</p> <p>Pas verifikimit të të dhënave lidhur me destinimin e hapësirës ku ndodhen parcelat në fjalë sipas Hartës Zonale të Komunës, ju njoftojmë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none">• Lokacioni për të cilat lëshohet ky informacion urban është e destinuar si Zonë Industriale, bashkangjitur gjeni skicën grafike dhe pjesën tekstuale nga HZK lidhur me sqarimet për këtë zonë. <p>Shfrytëzimi i tokës për këtë zonë është përcaktuar me pikën 5.2.1. të Hartës Zonale të Komunës – nga faqe 92 deri në faqe 94. Pjesën e shkëputur nga Harta Zonale të Komunës – ia bashkengjesim këtij dokumenti.</p> <p>Për çdo informacion shtesë apo paqartësi Harta Zonale e Komunës mund të shkarkohet edhe përmes faqes së Komunës.</p> | | | |

Nga të dhënat më lartë DPUMM konstaton se ky Akt mund të shërbejë si informacion për gjendjen aktuale sipas Hartës Zonale të Komunës, ndërsa procedurat tjera rreth zhvillimit të aktiviteteve ndërtimore do të zhvillohen konform rregullativës ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit dhe dispozitave tjera ligjore që rregullojnë fushën e shfytëzimit dhe ndërtimeve.


Bashkangjitur:

Skica grafike si dhe pjesa tekstuale nga HZK.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
ZR. - Dt.30.07.2024

Përpunoi:
Jalldyze Kallaba
Zyrtare për Leje Ndërtimi

J. Kallaba



Imri Semetishti
Drejtore i DPUMM

Semetishti

Pranuar nga: _____

Më datë: _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

| | | |
|-------------------------------------|---------------|--------------------|
| Pranuar me Primljeno: 10.12.2024 | | |
| Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 01-463/02-60878 | | |



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË
SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË
ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03 Prill 2019, neneve 14, 20 dhe 21 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-467/22763 të datës 08.05.2024 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit shpallë këtë:

NJOFTIM

**PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE TË NJOFTIMIT PUBLIK NR.01-462/01-48222 TË
DATËS 30.09.2024**

- I. **NJOFTOHEN** të gjithë aplikuesit dhe publiku se për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale në njoftimin publik për Zonën Kadastrale në Babush i Muhaxherëve, procesi i vlerësimit të ofertave për Konkursin Publik Nr. 01-462/01-48222 të datës 30.09.2024 ka përfunduar duke rekomanduar si përfitues ofertuesit si në vijim:

- **EUROMETAL SH.P.K.** me Numër Unik Identifikues 810657637 me adresë: Babush i Ri - Ferizaj, nga komisioni vlerësues është rekomanduar si përfitues për parcelën kadastrale si në vijim:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqe për shfrytëzim në m ² |
|-----|---------------|---------------------|----------------------|--|
| 1. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-10 | Babush i Muhaxherëve | 20000 m ² |

L. R. R. R. A. G. - L. R. A. D

- **NIKA PRO-ING SH.P.K.** me Numër Unik Identifikues **811052307** me adresë: Rruga „Rexhep Bislimi“ p.n. Ferizaj, nga komisioni vlerësues është rekomanduar si përfitues për parcelën kadastrale si në vijim:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqja për shfrytëzim në m ² |
|-----|---------------|---------------------|----------------------|---|
| 2. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-11 | Babush i Muhaxherëve | 10000 m ² |

- **DIGI PRINT SH.P.K.** me Numër Unik Identifikues **810844888** me adresë: Rruga „Ali Kelmendi“ nr.35, Prishtinë, nga komisioni vlerësues është rekomanduar si përfitues për parcelën kadastrale si në vijim:

| Nr. | Pronar | Parcela Kadastrale | Zona Kadastrale | Sipërfaqja për shfrytëzim në m ² |
|-----|---------------|---------------------|----------------------|---|
| 3. | Komuna Lipjan | P-71409059-00559-12 | Babush i Muhaxherëve | 13137 m ² |

- II.** Palët e pakënaqura nga procesi i vlerësimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të këtij njoftimi kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditë kalendarike pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave.
- III.** Pas përfundimit të afatit për parashtrimin e ankesave dhe shqyrtimit të tyre, Kuvendit Komunal i propozohet të miraton ofertat e përzgjedhura nga Komisioni Vlerësues.

1. Latif Ramadani, Kryesues i Komisionit

2. Rexhep Rexhepi, Anëtar

3. Armend Grajqevci, Anëtar

4. Lulzim Rrustemi, Anëtar

5. Arbnora Dedushi, Anëtare

Numër:

Datë: 10.12.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| | | |
|----------------------------|--------------|-------------------|
| Pranuar me datën: 10.01.25 | | |
| Nr. i Jedishtes | Nr. i Bregut | Shtypja e Dodshes |
| 15-462/01-2039 | | |



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

| | |
|--------|--|
| Datë: | 10.01.2025 |
| Për: | Daut Azemi - Kryesues i Kuvendit të Komunës |
| Kopje: | Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit |
| Nga: | Anëtarët e Komisionit Vlerësues të themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22763 të datës 08.05.2024 |
| Lënda: | Raporti i Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - ZK Babush i Muhaxherëve për vlerësimin e ofertave sipas Njoftimit publik Nr.01-462/01-48222 të datës 30.09.2024 |

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të Komunës ZK-Babush i Muhaxherëve.

Në afatin ligjor për ushtrimin e ankesave, ka pasur dy Ankesa, një ankesë nga ofertuesi Ballkan Panel L.L.C & L.G.S Metal Industries L.L.C me nr.protokolit 01-034/01-61836 të dates 17.12.2024, dhe një nga ofertuesi Gafurr Ibrahim B.I. Ankesat janë shqyrtuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, refuzohen si të pa bazuara Ankesat e ofertuesëve me Vendim Nr.01-034/01-61836 të datës 26.12.2024, si dhe Vendimi me Nr.01-463/02-64075 të datës 08.01.2025. Pasi që kemi pranuar edhe vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, prezanton:

Raportin

e vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit publik 01-462/01-48222 të datës 30.09.2024

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të Komunës ZK- Babush i Muhaxherëve, me Njoftimin publik Nr. 01-462/01-48222 të datës 30.09.2024 janë shpallur për dhënie në shfrytëzim pronat komunale si:

1. P-71409059-00559-10 me sipërfaqe 20000 m2
2. P-71409059-00559-11 me sipërfaqe 10000 m2
3. P-71409059-00559-12 me sipërfaqe 13137m2

Komisioni Vlerësues pas përmbylljes së afatit për aplikim të përcaktuar me Njoftimin publik ka pranuar dymbëdhjetë (12) oferta.

Të gjitha ofertat janë vlerësuar sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe lidhur me këte Komisioni ka mbajtur njëmbdhjetë (11) takime pune. Komisioni me datën 10.12.2024 ka përfunduar vlerësimin e ofertave dhe në bazë të kriterve të përcaktuara janë rekomanduar si përfitues ofertuesit si në vijim:

- EUROMETAL SH.P.K me Numër Unik Identifikues 810657637 me adresë: Babush i Ri,, nga Komisioni është rekomanduar si përfitues për parcelen P-71409059-00559-10 ZK Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe 20000 m2.

L.R. R. R A.G L. P. A. D

- NIKA PRO-ING SH.P.K. me Numër Unik Identifikues 811052307 me adresë: Rruga „ Rexhep Bislimi“ p.n Ferizaj, nga Komisioni është rekomanduar si përfitues për parcelën P-714090059-00559-11 ZK Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe 10000 m2.

- DIGI PRINT SH.P.K. me Numër Unik Identifikues 810844888 me adresë: Rruga „ Ali Kelmendi“ nr. 35 Prishtinë, nga Komisioni është rekomanduar si përfitues për parcelën P-714090059-00559-11 ZK Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe 13137 m2.

Njëkohësisht, Komisioni ka përgatitur “Njoftimin për përzgjedhjen e ofertës” i cili është publikuar me datën 10.12.2024.

Në afatin e paraparë ligjor për ushtrimin e ankesave, ka pasur dy ankesa nga ofertuesit, njëra ankesë nga ofertuesi Ballkan Panel L.L.C &L.G.S Metal Industries L.L.C me nr.protokolit 01-034/01-61836 të dates 17.12.2024, dhe nga ofertuesi Gafurr Ibrahim B.I 01-463/02-64075 të datës 30.12.2024, ankesat janë shqyrtuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, refuzohen si të pa bazuara Ankesat e ofertuesëve me Vendim Nr.01-034/01-61836 të datës 26.12.2024 për ofertuesin Ballkan Panel L.L.C &L.G.S Metal Industries L.L.C si dhe Vendimin Nr.01-463/02-64075 të dates 08.01.2025 për ofertuesin Gafurr Ibrahim B.I.

Pasi që kemi pranuar edhe vendimet e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, ku thuhet Mbetet në fuqi Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr.01-463/02-60878 i dates 10.12.2024.

Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - ZK Babush i Muhaxherëve për vlerësimin e ofertave, duke pasur parasysh proceset e zhvilluara konstaton se: Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr.01-463/02-60878 i datës 10.12.2024, administrativisht është akt përfundimtar dhe procedohet tutje.

Në Shtojcë të këtij Raporti bashkëngjesim dokumentet:

1. Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024.
2. Vendimin Nr.15-463/06-22763 për themelimin e Komisionit vlerësues.
3. Njoftimin publik Nr.01-462/01-48222 të datës 30.09.2024.
4. Njoftimi për përzgjedhjen e ofertave Nr.01-463/02-60878 i dates 10.12.2024.
5. Vendimet e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave me nr.01-034/01-61836 të datës 26.12.2024, si dhe Vendimin Nr.01-463/02-64075 të dates 08.01.2025.

Shënim: Të gjitha shkresat tjera lidhur me shqyrtimin e ofertave, duke përfshirë edhe ofertat e parashtruara nga palët janë dorëzuar në Sektorin për çështje pronësore – juridike.

Me respekt,

Anëtarët e Komisionit:


Latif Ramadani

Rexhep Rexhepi

Armend Grajqevci

Lulzim Rrustemi

Arbnora Dedushi





Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409059-00559-11

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
165/2025
14.01.2025 - 10:19
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:
Babush I Muhaxherëve / Muhadžer Babuš / Babushi I Muhaxherve
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:
LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

165/2025
14.01.2025 - 10:19
LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN
Babush I Muhaxherëve / Muhadžer Babuš / Babushi I Muhaxherve
LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m ²) | Pëshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|--|--|---|---------------------------|---|---|---|----------------------------------|
| P-71409059-00559-11 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 10000 | ndarje fiz. If. 1/2016 ndarje fiz. If. 2/2019 kor. kult.sip. kcid ak. kad.nr. 123-0807-21 | 19.04.2024 | |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|--|---|---|---|----------------------------------|
| BALKAN | | | 19.04.2024 | |



A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

| Numri Broj Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use | Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class | Sipërfaqja (m ²) Površina Area (m ²) |
|-------------------------|--|--|---|--|
| 1 | Bujqësore/Poljoprirvedno/Agriculture | Kullosat/Pashnjaci/pasunne | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | 10000 |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Te drejtat Prava Rights | Emri Ime Name | Nr. personal Liceni broj ID. No. | Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi postal Poštanski kod Postal code | Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Pershkrimi Opis Description | Azhuruar Ažurirano Updated |
|--|---------------------|--|--|---|---|--|-----------------------------------|----------------------------------|
| Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor | Komuna e Lipjanit | 600371588 | /// | | SHQIPËRIA | 1/1 | | 22.04.2024 |



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Babush I Muhaxherëve

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Povšina/Area m ² |
|----------------------|----------------------------|--|
| P-71409059-00559-10 | Parcelë / Parcela / Parcel | 20000 |
| P-71409059-00559-11 | Parcelë / Parcela / Parcel | 10000 |
| P-71409059-00559-12 | Parcelë / Parcela / Parcel | 13137 |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2085

Punoi/Obradio/Created: Izjah Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.01.2025

Koha/ Vreme/ Time: 03:32:49